REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 927/20
Datë/Datum. 12.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Arsimit

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**208 Udheheqesi-20-3925-1-1-1**
Nr i brendshëm	**208020019111**

Sa i përket tenderit për: Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne,modernizimi i sherbimeve neper shkolla si dhe furnizimi me pajisje të sherbimeve online për shkollat e të verberve

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Botek shpk**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 517, *Prishtinë, 10 000***

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it: **038/245830 / 038/245625**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Hilmi Asllani**

Adresa elektronike: **hilmi.asllani@bo-tek.com**

Data e parashtrimit të ankesës: 11.11.2020 **Nënshkrimi dhe vula:**

IT · Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
Prishtinë, Republika e Kosovës 2003 2015

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë "apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontrate: 27.07.2020.**
- **Afati i fundit për dorëzim te tenderit: 17.08.2020, ora 13:00.**
- **Kriteri për dhënien e kontratës : Çmimi më i ulët.**
- **Përgjigjja e AK për sqarimet e Dosjes se Tenderit e publikuar ne platformën e E-prokurimit : 07.08.2020.**
- **Kerkese per qasje ne dokumente: 31.08.2020**
- **Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës se e-Prokurimit: 02.09.2020.**
- **Vendim i Autoritetit Kontraktues mbi Refuzimin e Kërkesës për Ri-Shqyrtim: 10.09.2020.**
- **Ankesa në OSHP: 16.09.2020.**
- **Vendimi nga OSHP, nr 673-20: 22.10.2020.**
- **Vendimi i AK, pas rivlerësimit: 30.10.2020.**
- **Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës se e-Prokurimit: 03.11.2020.**
- **Vendimi (nr 2993) i AK mbi Refuzimin e Kërkesës për Ri-Shqyrtim: 05.11.2020**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Procesverbali i hapjes është publikuar në platformën e E-Prokurimit, me datë 17.08.2020.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Me datën 03.11.2020 përmes platformës se e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit

Me datën 05.11.2020 kemi pranuar vendimin nga AK për refuzimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

- Neni 1, paragrafi i LPP Nr. 04/L-042 Qëllimi

- Neni 6 i LPP Nr. 04/L-042 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

- Neni 52 i LPP Nr. 04/L-042 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

- Neni 56, paragrafi 3 i LPP Nr. 04/L-042 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

- Neni 59, paragrafi 4 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

- Neni 72 i LPP Nr. 04/L-042 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me dispozitat e nenit 108A të LPP ne kemi parashtrua Kërkesë për ri-shqyrtim kundër vendimit të AK-Ministria e Arsimit lidhur me aktivitetin e prokurimit *"Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve neper shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve"* me nr. të prokurimit Nr. i Prokurimi 208 Udheheqesi-20-3925-1-1-1. Nr. i brendshëm 208020019111 sepse i njëjti ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP PSH.nr: 673/20, dt. 22.10.2020.

AK me rastin e ri-vlerësimit të tenderit nuk ke vepruar në pajtim me vendimin e lartcekur të OSHP, i njëjti ashtu siç kemi parashtruar edhe në ankesën drejtuar OSHP se, AK është i përcaktuar paraprakisht për OE të rekomanduar për kontratë dhe me këtë ka bërë:

- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe Vendimit të OSHP

Se AK ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike është evidente dhe atë me qëllim vetëm për të favorizuar OE të tyre të preferuar edhe përkundër vendimit të OSHP-ës PSH.nr: 673/20.

Në Vendimin e AK duke hedhur poshtë Kërkesën tonë për Rishqyrtim, shihet tendenca edhe me tutje dhe qëllimi i qartë i tyre për të keqpërdorë buxhetin e shtetit dhe veprimet e tyre tendencioze.

AK (MASHT) pasi që kishte dështuar në procedurën e parë të vlerësimit të Tenderit, duke provuar përmes 7 Pikave (të paqena) të manipuloj edhe vetë OSHP, duke konstatuar rrejshëm fakte të paqena si dhe duke bërë shtrembërime dhe fshehje të qëllimshme të fakteve dhe dokumenteve të dorëzuara nga ne si OE në dosjen e tenderit.

AK tani në procedurën e Ri-vlerësimit pasi që i ka harrua të gjitha pretendimet e mëhershme të tyre të cilat ishin krejt manipulim i pastër dhe keqpërdorim, gjen sërish aq shumë kohë dhe investon energji sa për ti mbushur faqe të tëra me gjëra të paqena dhe koti ne vendimin e tyre duke u fokusuar dhe pretenduar një pikë të vetme dhe ma konkretisht 100% në një parametër të vetëm (Frekuencës) të një pjese të tabletit (CPU).
Krejt kjo tregon tendencën e AK për të keqpërdor pozitën e tyre zyrtare dhe me qëllim të përfitimit të dikujt nga brenda apo jashtë Institucionit MASHT edhe buxhetin e shtetit të Kosovës.

AK jo vetëm se NUK ka tregua asnjë kompetencë profesionale për ta vlerësuar teknikisht këtë lëndë por ekzistojnë dyshime të bazuara se i gjithë shkrimi në Vendimin e tyre NUK është i përpiluar fare ne MASHT, po gjetiu jashtë institucionit, e sipas të gjitha analizave edhe jashtë vendi (pra jo në Kosovë).

Ne duhet ti përgjigjemi AK në pretendimet dhe fryrjet që ata ia lejojnë vetes si Institucion me i lartë shtetërorë mbi edukimin dhe shkollimin në Kosovë, që i kanë bërë në vendimet e tyre në adresën e kompanisë sonë BOTEK dhe stafi i saj profesional, duke iu thënë; *"Ne edhe mund ndonjëherë të mos e njohin në thellësinë e mjaftueshme matematikën jashtëzakonisht komplekse të konceptimit dhe prodhimit të CPU-ve, por jemi krenarë me njohjet tona profesionale dhe me punën tonë me dinjitet, dhe do ta ruajmë respektin në komunikim dhe vlerësimin tonë për institucionin e Ministrisë si të tillë dhe buxhetin e Republikës së Kosovës". Edhe ne ketë pjesë, jemi të bindur se edhe kjo pjesë NUK është shkruar në MASHT dhe por diku nga jashtë e besa as ne Kosovë jo.*

Rrjedhimisht, ne kundërshtojmë me fakte plotësisht Vendimin e AK gjatë Rivlerësimit dhe Vendimin e tyre në Kërkesën tonë për Rishqyrtim si dhe konsiderojmë se AK ka bërë sërish shkelje të LPP si dhe AK me vetëdije NUK po e zbatojnë Vendimin e OSHP-së i cili është obligativ për AK.

Pra, Duke u bazuar në raportin e ekspertizë (673/20, dt. 05.10.2020) të dhënë për këtë lëndë me të cilin ne jemi pajtuar dhe mbi të cilin edhe OSHP-ja e kishte bazuar dhe lëshuar Vendimin (PSH.nr: 673/20, dt. 22.10.2020), me q rast ishte aprovua ankesa dhe pretendimet tona si të bazuara dhe ishte kërkuar që lënda të kthehej në Ri-vlerësim.

Ne edhe njëherë përtej provave teknike të dhëna ne procedurën e kaluar të Ankimimit e të cilat vlejnë edhe për këtë procedurë, po i Ri-konfirmojmë vetëm deklarimin e Ekspertit kur edhe e qartëson ketë pretendim të AK dhe deklaron se "përformancen e procesorit nuk e përcakton vetëm numri i frekuencës (GHz) dhe NUK është element absolut apo indikatorë mbi bazën e të cilit mund të krahasohen dhe vlerësohen dy procesorë. (Këtu duhet ta plotësojmë dhe ta Ri-konfirmojmë gjithashtu se CPU-ja e pajisjes së ofertuar nga ne e ka numri i Cora-ve të njëjtë me atë që kërkohet ne Anexin 1 të DT).

Tutje eksperti i kësaj lënde në ekspertizën e tij sqaron, ***Citat;*** *"Nëse bëjmë krahasimin e procesorit të ofertuar nga OE ankues (UNISOC SC9863A) dhe procesorit të pajisjes së ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë (MediaTek Helio P22T (8xARM Cortex-A53, up to 2.3GHz)), procesori i ofertuar nga OE ankues është Cortex-A55 (ARMv8.2-A) ndërsa procesori i OE të rekomanduar për kontratë është Cortex-A53 (ARMv8.0-A).Sipas informatave të ARM kups://community.arnt.cont/developer/ip-products/processors/b/processors-ip-bloz/posulann-cortex-a55-efficient-performance-from-edge-to-clondj, procesori Cortex-A55 është gjeneratë pasardhëse e procesorit ARM Cortex-A53, i krijuar për të përmirësuar performancën dhe efikasitetin e energjisë. Gjithmonë sipas informatave të prodhuesit ARM, arkitektura Cortex A55 është për 15% më efikas në energji dhe 18% rritje të performancës në krahasim me A53."*.

Prandaj, duke pas parasysh Ekspertizën e dhënë për ketë lëndë ku përfshihet edhe ky pretendim (i pabazuar) i AK si dhe Vendimin e OSHP i mbështetur pikërisht në pretendimet/Provat tona dhe këtë ekspertizë dhe ku çdo kund është qartësuar përtej çfarëdo dileme e mbështetur në argumentet dhe provat e prezantuara në procedurë, konsiderojmë se AK me këtë vendim tyre sërish për të na eliminuar ofertën tonë me pretendime të paqena edhe njëherë më shumë kanë shkelë LPP si dhe NUK kanë respektuar vendimin e OSHP (PSH.nr: 673/20).

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK (MASHT-in) ta Respektoj Vendimin e OSHP të lëshuar për këtë lëndë dhe të Anulon Vendimin e datës 30.10.2020 me të cilin kanë eliminuar ofertën tonë pa asnjë argument të vetëm si dhe kanë propozuar për kontratë grupin e OE *"Infosoft Systems shpk & Future Bits shpk"*, ofertë kjo 38 % me të lartë se oferta jonë financiare, duke dëmtuar rëndë buxhetin e shtetit.

Bazuar në të cekurat më lartë lehtësisht konstatojmë se AK ka bërë një mal shkeljesh të dispozitave të LPP-ës dhe atë:

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me çmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me **nenin 1 të LPP**, citat i nenit 1.1 të LPP- ës: *"1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".*

- Po ashtu edhe **neni 6 i LPP-së** i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike, citat; *"Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet*

publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit". - Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës".

- AK nuk ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave konform **nenit 59.4 të LPP**. përcakton, citojmë: *" 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."*

- AK si kriter të saj për dhënien e kontratës është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët ashtu siç e parasheh **neni 52 të LPP** por në praktik është e kundërta me veprimet e saja AK (MASHT) e eliminon ofertën e përgjegjshme me çmim më të ulët (**823.500€ të OE BOTEK shpk. apo 165€/copë)** dhe propozon për kontratë një ofertë tejmase me të lartë **1.139.400€, apo 227€/copë, rrjedhimisht 38% me të lartë)** Për Informacionin tuaj; Çmimet standarde (me pakicë) gjithandej nëpër Evropë janë më të ulëta, sikurse:

https://gjirafa50.com/celulare-tablete-dhe-pajisje-smart/tablete/me-google-android/tablet-lenovo-m10-plus,-4gb-64gb,-hiri/#rel=2

https://www.idealo.de/preisvergleich/OffersOfProduct/7041006_-tab-m10-plus-za5t0302-lenovo.html

(Gjermani – DE, çmimet mesatare të këtij Tableti Inkl. VAT dhe Transporti në shtëpi kudo ne DE).

https://www.coolshop.co.uk/product/lenovo-m10-fhd-plus-2nd-gen-tb-x606f-tablet/234S9V/?utm_medium=affiliate&utm_source=salestring&utm_campaign=The+Affiliate+Gateway%E2%80%8B

(Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakicë për copë incl. VAT dhe Transporti deri në shtëpi kudo ne UK).

https://www.lenovo.com/gb/en/tablets/android-tablets/lenovo-tab-series/Lenovo-TB-X606Smart-Tab/p/ZZITZTMST0X
(Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakicë për copë incl. VAT dhe Transporti në shtëpi ne UK)

- Se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit **56.3 të LPP** është evidente sepse ka eliminuar ofertën ton e cila ka plotësuar kushtet dhe kriteret e kërkuara në DT.

- Bazuar në **nenit 72 AK** ka pas mundësin që përmes kësaj dispozite të kërkoj çfarëdo sqarimi të tenderit, nëse ka pas paqartësi në ofertën tonë, dhe është e pa pranueshme që AK nuk e ka përdor këtë dispozitë të LPP për të marr një vendim meritor por spekulojnë në mënyrë tendencioze në pretendimet e tyre duke u thirre në fakte të paqena.

Prandaj, bazuar në të gjeturat e cekura më lartë, kërkojmë nga paneli i OSHP me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, të këtij aktiviteti të prokurimit: *"Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne,modernizimi i sherbimeve neper shkolla si dhe furnizimi me pajisje të sherbimeve online për shkollat e të verbërve"*, nr. i prokurimit208 Udheheqesi-20-3925-1-1-1 të iniciuar nga MASHT- të të merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar Ankesa e OE:"Botek"sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit: *" Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve", nr. i prokurimit 208 Udhëheqesi-20-3925-1-1-1 .*

2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: *" Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve neper shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve"*, nr. i prokurimit 208 Udheheqesi-20-3925-1-1-1 dhe rekomandohet për kontratë OE "Botek"SHPK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara me rastin e përgatitjes së Kërkesës për Ri-shqyrtim te Autoriteti Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
Humbja e fitimit të parashikuar nga kontrata

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

1. **B05 Njoftimi për kontrate: 27.07.2020**
2. **Deklarata mbi specifikimet teknike.**
3. **Raporti i ekspertit shqyrtues: 05.10.2020.**
4. **B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK: 30.10.2020.**
5. **Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës se e-Prokurimit: 03.11.2020**
6. **Vendimi i AK mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim: 05.11.2020**
7. **Dëshmia Pagesa e Ankesës ne OSHP**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*